



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
I SANKSIONEVE

Data: 11 Maj 2021

Nr: 72

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 48, PARAQITUR NË  
KQZ NË DATËN 10.05.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 11.05.2021, me pjesëmarrjen e:

Ledio BRAHO - Relator  
Elvin LAKO - Anëtar  
Elvis ÇEFA - Anëtar  
Ilirjan RUSMALI - Anëtar  
Koli BELE - Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Partia Lëvizja Socialiste për Integrim;

**OBJEKT:** Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 48, paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve datë 10.05.2021.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,



## VËREN:

Partia Lëvizja Socialiste për Integrim ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 48 regj., datë 10.05.2021.

Në mbledhjen e datës 11.05.2021, ora 12:00, pas relatimit të z. Ledio Braho u konstatua se kërkesa ankimore nr. 48 i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, të Komisionit Rregullator, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

## PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17, pika 3, shkronjat “a” e 18, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator,

## V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 48, datë 10.05.2021, të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 12 Maj 2021, në orën 14:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

**Ledio BRAHO - Relator**

**Elvin LAKO - Anëtar**

**Elvis ÇEFA - Anëtar**

**Ilirjan RUSMALI - Anëtar**

**Koli BELE - Anëtar**

